



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 84/8 Prot.

Tiranë, më 31.03.2026

V E N D I M

Nr. 68, Datë 31.03.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 14, datë 12.01.2026, nga Qendra për Drejtësi Gjinore, përfaqësuar nga znj. A. V., e cila është autorizuar të përfaqësojë në këtë ankesë znj. R. Gj., kundër Shkollës Speciale Vlorë me pretendimin se fëmija i saj T. Ç., dhe ankuesja janë diskriminuar për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “përgjegjësisë prindërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, ndër të tjera, informon se: “Prej muajit Qershor 2025, Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, në partneritet me Bashkinë Vlorë, ka ngritur Qendrën e Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara në Vlorë. Kjo qendër është ngritur në kuadër të projektit “Krijimi i një shërbimi të ri të specializuar të kujdesit social për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në Bashkinë Vlorë”, përmes nën-granteve të programit “BE për Kujdesin Social”, mbështetur nga UNICEF Albania me fonde të Bashkimit Europian.

Tashmë Qendra e Kujdesit Ditor është licencuar si Qendër për Shërbime Komunitare për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara dhe menaxhohet nga Bashkia Vlorë. Qendra për Drejtësi Gjinore ka rol mbështetës deri në muajin Prill 2026, periudhë pas së cilës Bashkia Vlorë do ta menaxhojë tërësisht vetë këtë Qendër. Aktualisht Qendra po funksionon me kapacitet të plotë dhe po marrin shërbime më tepër se 35 fëmijë.

Gjatë muajve të fundit jemi përballur me një situatë sfiduese me Drejtorinë e Shkollës Speciale Vlorë, pasi disa prej fëmijëve vinin në Qendrën Ditore pas përfundimit të procesit mësimor atje, në

mënyrë që të merrnin shërbime të specializuara, përfshirë kujdes ditor deri në orën 16:30. Kjo i jepte mundësinë prindërve që të punonin dhe të merrnin fëmijët pas punës në Qendrën Ditore. Nisur nga fakti se Qendra Ditore nuk ka transport të përfshirë dhe Shkolla Speciale e ofron këtë shërbim, fillimisht transporti i fëmijëve për në Qendrën Ditore nga Shkolla Speciale është kryer nga kjo e fundit (edhe pse në mjetin e transportit qëndronte vetëm shoferi, pa mësuese ose kujdestare shoqëruese).

Në muajin Nëntor 2025, ky shërbim nuk u ofrua më nga Shkolla Speciale vetëm për fëmijët që frekuentonin Qendrën Ditore. Kjo për shkak të mungesës së vullnetit nga ana e Drejtueses së Shkollës Speciale. Theksojmë se të gjithë fëmijët e tjerë që frekuentojnë Shkollën Speciale shoqërohen me transport për në shtëpitë e tyre (ndërsa fëmijëve që frekuentojnë Qendrën Ditore nuk u ofrohet transport). Këtu ne gjejmë shkaqe për diskriminim. Prindërit e fëmijëve që marrin shërbime në Qendrën Ditore kanë qenë përherë të disponueshëm që të firmosin një deklaratë pranë Shkollës Speciale ku japin miratimin e tyre që fëmijët të transportohen nga Shkolla Speciale tek Qendra Ditore pas procesit mësimor, por kjo nuk është marrë në konsideratë nga Drejtoria e Shkollës Speciale.

Një prej rasteve është T. Ç., 8 vjeçe, fëmijë me aftësi të kufizuara. Nëna e saj, Rediona Gjataj, është e divorcuar dhe kujdeset e vetme për T. R., e ka të pamundur që çdo ditë të shkojë pranë Shkollës Speciale kur përfundon procesi mësimor, të marrë vajzën e saj dhe ta shoqërojë tek Qendra Ditore, për ta marrë sërish në orën 16:30. Fëmijëve të tjerë iu vendoset në dispozicion transport nga kjo shkollë, por T., i është refuzuar ky shërbim. Ditët e fundit, sipas referimeve të nënës së T., nga Shkolla Speciale i është thënë: "nëse ti nuk ke mundësi ta marrësh vetë fëmijën dhe ta shoqërosh tek Qendra Ditore, çoje që në mëngjes atje dhe nuk ka nevojë të vijë në shkollë". Këtu lind një problematikë tjetër: nga një institucion arsimor po stimulohet braktisja e arsimit të detyrueshëm për një fëmijë me aftësi të kufizuara. Theksojmë se në marrëveshjen e pranimin në Qendrën Ditore, nënshkruar nga ky institucion dhe nëna e T., është parashikuar se "shërbimi ndërpritet nëse prindi/kujdestari ka shkëputur fëmijën nga frekuentimi i arsimit të detyrueshëm". Kjo për faktin se, prej fillimit të funksionimit të Qendrës Ditore, është parashikuar risku që prindërit mund t'i shkëpusin fëmijët nga procesi arsimor dhe të ndihen të predispozuar të sjellin fëmijët në orën 7:30 në Qendrën Ditore dhe t'i marrin në 16:30. Qendra Ditore në mënyrë absolute nuk stimulon braktisjen e arsimit të detyrueshëm.

Për më tepër, po na vijmë vazhdimisht referime nga prindërit se drejtuesja e këtij institucioni po i dezinformon duke i thënë se: nuk duhet t'i çojnë fëmijët tek Qendra e Kujdesit Ditor pasi do mbyllet (theksojmë sërish se Qendra është licencuar nga Bashkia Vlorë dhe gjatë vitit 2026 do të vijojë ofrimin e shërbimeve mbështetur tërësisht nga buxheti i Bashkisë Vlorë) dhe se këtë shërbim, deri në orën 16:30, do ta ofrojë në të ardhmen vetë Shkolla Speciale.

Nisur nga situata e mësipërme, jemi në kushtet ku T. Ç., fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe nëna e saj R. Gj., po i mohohet përfitimi i shërbimeve ditore të specializuara dhe të qëndrueshme pas procesit mësimor.

E njëjta situatë vlen edhe për fëmijë të tjerë, të cilët prindërit nuk kanë mundësi t'i marrin nga Shkolla Speciale dhe t'i sjellin vetë në Qendrën Ditore. Disa fëmijë nuk frekuentojnë më Qendrën Ditore për këtë arsye. Jemi në kushtet ku, për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga Drejtoria e Shkollës Speciale dhe diskriminimit që kjo shkollë po kryen, disa prej fëmijëve me aftësi të kufizuara po u mohohet përfitimi i shërbimeve të specializuara.

Masat që kërkohen të ndërmeren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë që të shqyrtojë sa më parë pretendimet e mësipërme dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme që disa nga fëmijët që frekuentojnë Shkollën Speciale Vlorë, të mos diskriminohen në përfitimin e shërbimeve të specializuara pas procesit mësimor në Qendrën e Kujdesit Ditor. Kërkohet që Shkolla Speciale, në të njëjtën mënyrë siç transporton të gjithë fëmijët në destinacion pas përfundimit të procesit mësimor, të transportojë edhe fëmijët që frekuentojnë Qendrën Ditore nga Shkolla Speciale drejt Qendrës Ditore, duke i shoqëruar në mjetin e transportit nga mësuese dhe/ose kujdestare.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit të ankesës nr. 14, datë 12.01.2026, nga Qendra për Drejtësi Gjinore, përfaqësuar nga znj. A. V., e cila është autorizuar të përfaqësojë në këtë ankesë znj. R. Gj., kundër Shkollës Speciale Vlorë, me pretendimin se fëmija i saj T. Ç., dhe ankuesja janë diskriminuar për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “përgjegjësisë prindërore”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 84/1 prot., datë 21.01.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shkolla Speciale Vlorë, ZVAP Vlorë-Himarë, Bashkia Vlorësi më posht vijon:

Për Shkollën Speciale Vlorë

- Informacion mbi arsyet se përse fëmijët që frekuentojnë Qendrën e Kujdesit Ditor nuk kanë përfituar transport nga Shkolla Speciale pas përfundimit të procesit mësimor, ndërkohë që fëmijët e tjerë të shkollës e përfitojnë këtë shërbim.
- Shpjegim konkret përse transporti nga Shkolla Speciale drejt Qendrës Ditore është ndërprerë që nga Nëntori 2025, edhe pse prindërit kanë dhënë miratimin me shkrim për transport.

- Sqarim përse nuk është marrë parasysh deklarata e prindërve që japin miratimin për transportin e fëmijëve drejt Qendrës Ditore.
- Informacion mbi kriteret e përdorura për të vendosur se cilët fëmijë përfitojnë transport nga shkolla dhe cilët jo.
- Sqarim përse në mjetin e transportit që dërgon fëmijët në Qendrën Ditore nuk shoqërohet mësuese ose kujdestare, ndonëse kjo është një praktikë e nevojshme për sigurinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Informacion mbi arsyet se përse i është refuzuar transporti T. Ç., 8 vjeçe, ndërkohë që fëmijëve të tjerë të shkollës u ofrohet transport.
- Sqarim për deklaratën e bërë ndaj nënës së Terezës, ku i është thënë se nëse nuk mund ta marrë vetë fëmijën, atëherë fëmija nuk ka nevojë të vijë në shkollë.
- Shpjegim nëse Shkolla Speciale ka plan të ofrojë vetë transport për fëmijët që frekuentojnë Qendrën Ditore dhe nëse po, kur pritet të nisë ky shërbim.
- Informacion nëse Shkolla Speciale ka njoftuar në mënyrë zyrtare prindërit për ndërprerjen e transportit dhe për arsyet e kësaj ndërprerjeje.
- Sqarim nëse Shkolla Speciale ka ndërmarrë ndonjë veprim për të siguruar bashkëpunim me Qendrën e Kujdesit Ditor dhe për të garantuar mosdiskriminimin e fëmijëve që frekuentojnë këtë qendër.

Për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë

- Sqarim nëse Zyra Vendore e Arsimit ka njohuri për këtë situatë dhe nëse është njoftuar zyrtarisht nga Shkolla Speciale apo nga prindërit.
- Informacion mbi veprimet e ndërmarra nga Zyra Vendore e Arsimit në lidhje me ndërprerjen e transportit nga Shkolla Speciale për fëmijët që frekuentojnë Qendrën e Kujdesit Ditor.
- Informacion nëse Zyra Vendore e Arsimit ka kryer verifikime në terren për të parë nëse ka diskriminim ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë Qendrën Ditore.
- Shpjegim nëse Zyra Vendore e Arsimit ka kërkuar nga Shkolla Speciale të sigurojë transportin për fëmijët që frekuentojnë Qendrën Ditore.
- Sqarim nëse Zyra Vendore e Arsimit ka ndonjë udhëzim ose protokoll për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe për bashkëpunimin me shërbimet sociale (si Qendra e Kujdesit Ditor).
- Informacion nëse Zyra Vendore e Arsimit ka marrë masa për të garantuar që fëmijët me aftësi të kufizuara të mos diskriminohen në aksesin e shërbimeve pas procesit mësimor.

Për Bashkinë Vlorë

- Informacion mbi rolin e Bashkisë Vlorë në menaxhimin e Qendrës së Kujdesit Ditor dhe për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Sqarim nëse Bashkia Vlorë ka marrë njohuri për ndërprerjen e transportit nga Shkolla Speciale dhe nëse ka ndërmarrë veprime për të adresuar këtë problem.

- Informacion nëse Bashkia Vlorë ka plan për të siguruar transportin për fëmijët që frekuentojnë Qendrën Ditore, në mënyrë që ata të mos diskriminohen në aksesin e shërbimeve.
 - Sqarim nëse Bashkia Vlorë ka marrë masa për të garantuar që Shkolla Speciale të mos keqinformojë prindërit për funksionimin e Qendrës Ditore (*p.sh., për pretendimin se Qendra do të mbyllet*).
 - Informacion nëse Bashkia Vlorë ka një protokoll bashkëpunimi me Shkollën Speciale për transportin e fëmijëve drejt Qendrës Ditore.
 - Sqarim mbi masat që do të ndërmerren nga Bashkia Vlorë për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të mos humbasin shërbimet pas procesit mësimor për shkak të mungesës së transportit.
- Me shkresën nr.231/1 prot., datë 28.01.2026¹, Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Himarë-Vlorë, ktheu përgjigje Komisionerit dhe dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me këtë çështje, ku informon se:

Referuar kërkesës tuaj me lëndë: Njoftim dhe kërkesë për informacion me nr. 86/1 Prot., datë 21.01.2026, protokolluar pranë ZVAP Vlorë-Himarë me nr. 231 Prot., datë 22.01.2026 dhe në mbështetje të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ju bëjmë me dije se: ZVAP Vlorë Himarë, me marrjen e këtij, ka kërkuar informacion të detajuar nga Shkolla Speciale PLM Vlorë, e cila na informon se: Shkolla Speciale nuk disponon asnjë Marrëveshje Bashkëpunimi me Qendrën e Kujdesit Ditor për fëmijë dhe të rinj me Aftësi të Kufizuara, as me postë elektronike, as zyrtare. Transporti i nxënësve të shkollës realizohet në përputhje me kontratën e qerasë, e lidhur kjo nga Bashkia Vlorë me subjektin: "Trans Babica 17" sh.p.k., me Administrator z. Petrit Gjikonaj, me qëllim transportin e nxënësve vetëm për itinerarin banesë-shkollë-banesë.

Ne si institucion arsimor kemi primare sigurinë, mirëqenien dhe arsimimin e nxënësve të kësaj shkolle.

Për sa më sipër ZVAP Vlorë Himarë paraqet parashtrimet e saj si më poshtë vijon:

1- ZVAP bën me dije se deri në momentin e marrjes së kësaj shkrese nuk ka pasur asnjë njoftim zyrtar apo ankesë të protokolluar, nuk jemi njoftuar nga Shkolla Speciale as nëpërmjet postës elektronike dhe as me shkresë zyrtare për sa pretendohet. Pranë ZVAP nuk rezulton të jetë protokolluar asnjë kërkesë me shkrim apo marrëveshje bashkëpunimi ku të na bëjë me dije për rastin e mësipërm.

¹ Administruar pranë Komisionerit me nr.84/3 prot, datë 02.02.2026.

2- Në mungesë të informacionit dhe të një marrëveshjeje apo kontrate bashkëpunimi ZVAP nuk mund të ndërmarrë veprime.

3- Sqarojmë se nuk kemi asnjë informacion apo ankesë për diskriminim dhe se në Shkollën Speciale është SHPS e cila raporton çdo problematikë në rast se ka.

4- Theksojmë se ZVAP Vlorë Himarë ka përgjegjësinë për arsimimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, kurse menaxhimi i shërbimeve sociale dhe financimi i transportit të këtyre fëmijëve drejt kësaj Qendre Ditore është kompetencë e Bashkisë Vlorë.

5- ZVAP zbaton udhëzimet e Ministrisë së Arsimit për transportin e nxënësve. Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë", neni 19 "Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve", ku citohet se: Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Si dhe në VKM e datës 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", pika I/c/ç ku citohet se:

Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:

c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në IAP-të publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara, që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik;

Sqarojmë se rasti i T. C., nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë e sipërcituara të VKM-së së datës 01.03.2023, pasi diagnoza e nxënëses është CSA (Çrregullim i Spektrit Autik) dhe prapambetje mendore.

6- ZVAP Vlorë Himarë është përgjegjëse për procesin mësimor që prej fillimit e deri në përfundim të tij, duke synuar në gjithëpërfshirjen gjatë orës së mësimit. Nuk është kompetencë e ZVAP-së angazhimi apo aktivitetet përforcuese të këtyre fëmijëve pas procesit mësimor. Transporti financohet dhe menaxhohet nga pushteti vendor (Bashkia Vlorë).

Theksojmë se duke qenë se interesi i lartë i fëmijëve të këtij institucioni arsimor është parësor, jemi të gatshëm për bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe shërbimet sociale për t'ju ardhur në ndihmë nxënësve të kësaj shkolle.

- Me shkresën nr.263 prot., datë 29.01.2026², Shkolla Speciale Vlorë, ktheu përgjigje Komisionerit dhe dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me këtë çështje, ku informon se:

Në vijim të shkresës suaj me nr. protokoll 84/1, dt. 21.01.2026, protokolluar pranë institucionit tonë në dt. 22.01.2026 me nr. protokoll 258 dhe në frymën e bashkëpunimit institucional, ju dërgojmë informacionin lidhur me çështjen e ngritur.

Shkolla Speciale, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, e bazon funksionimin në legjislacionin në fuqi për arsimin dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, ku janë të përcaktuara qartë kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e institucionit arsimor. Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se institucioni ynë nuk disponon asnjë njoftim zyrtar, shkresë apo kërkesë formale për bashkëpunim, lidhur me shoqërimin e nxënësve pas përfundimit të procesit mësimor drejt Qendrës Ditore të përmendur, si dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që të dokumentojë në mënyrë zyrtare funksionimin mbi një bazë ligjore të kësaj qendre në raport me shkollën. Shërbimi i transportit që ofrohet për nxënësit e Shkollës Speciale është i dedikuar për nevojat arsimore dhe realizohet vetëm për itinerarin banesë-shkollë-banesë. Ky shërbim është siguruar nëpërmjet një kontrate qeraje të lidhur nga Bashkia Vlorë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil, dhe mjeti i transportit vihet në përdorim për këtë qëllim.

Sa i përket pjesës ku përmendet ndërprerja e shërbimit të transportit drejt Qendrës Ditore, sqarojmë se nuk ka pasur asnjë fillim zyrtar dhe ndërprerje zyrtare të një shërbimi të tillë, për shkak se Shkolla Speciale nuk ka asnjë marrëveshje bashkëpunimi me këtë institucion. Deklaratat e paraqitura nga prindërit janë mirëpritur nga shkolla, në frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit. Megjithatë, prindërve u është bërë e ditur se, në mungesë të një baze ligjore dhe dokumentacioni zyrtar, institucioni ynë nuk është në kushtet për të realizuar këtë shërbim.

Siguria dhe interesi më i lartë i fëmijëve mbeten prioritet absolut për Shkollën Speciale. Çdo praktikë mbështetëse e ndjekur ndër vite është realizuar vetëm në këtë frymë dhe pa cenuar kompetencat ligjore të institucionit. Në lidhje me nxënësen T. C., sqarojmë se shërbimi i transportit nga banesa në shkollë dhe anasjelltas nuk i është mohuar në asnjë moment.

Në lidhje me deklaratën e cituar se i është bërë nënës së nxënëses T., sqarojmë se Shkolla Speciale nuk disponon asnjë deklaratë të tillë në arkivën e saj. Përkundrazi, në dy raste kur nëna e nxënëses nuk ka pasur mundësi ta marrë nga shkolla, institucioni disponon dokumentacion të rregullt që vërteton procedurën e ndjekur për dorëzimin e nxënëses tek persona të autorizuar nga nëna, në kuadër të një bashkëpunimi korrekt me prindin dhe pa cenuar sigurinë e fëmijës.

Për sa i përket pyetjes nëse shkolla ka në plan të ofrojë transport për fëmijët që dëshirojnë të frekuentojnë Qendrën Ditore, sqarojmë se Shkolla Speciale nuk disponon mjet transporti në pronësi. Mjeti i transportit është përfutur nëpërmjet një kontrate me Bashkinë Vlorë, për qëllimin

² Administruar pranë Komisionerit me nr.84/4 prot, datë 02.02.2026.

e transportit të nxënësve nga banesa në shkollë dhe anasjelltas, sipas itinerarit të miratuar. Shkolla Speciale nuk ka asnjë marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Ditore për këtë qëllim. Në mungesë të një marrëveshjeje zyrtare, shkolla nuk ka qenë dhe nuk është në kushtet për të kryer njoftime zyrtare për ndërprerje të një shërbimi që nuk ka qenë i miratuar institucionalisht. Së fundi, theksojmë se Shkolla Speciale është një institucion arsimor në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe, si e tillë, nuk ka kompetencë për të lidhur marrëveshje ndërinstitutionale pa ndërmjetësimin dhe miratimin e instancave më të larta.

Ne si institucion arsimor nuk disponojmë asnjë marrëveshje të tillë të miratuar, ku të jenë të përcaktuara me detaje procedurat e dorëzimit të nxënësve në Qendrën Ditore. Kjo për arsye se nuk bëhet fjalë vetëm për nxënës në moshë të mitur, por edhe për nxënës me nevoja të veçanta, dhe siguria e tyre është parësore për ne. Mbetemi të hapur për bashkëpunim brenda kornizave që na lejohen nga legjislacioni në fuqi.

- Me shkresën nr.08 prot., datë 30.01.2026³, pala ankuese solli informacionin sqarues dhe dokumentacionin shtesë lidhur me ankesën.
- Me shkresën nr. 84/6 prot., datë 04.02.2026 të Komisionerit i është përcjellë palës ankuese shkresa nr.231/1 prot., datë 28.01.2026 të ZVAP Vlorë-Himarë dhe nr.263 prot., datë 29.01.2026 e Shkollës Speciale “PLM”, Vlorë, (dokumentacionin bashkëlidhur), për të bërë parashtrimet e saja në lidhje me këto përgjigje. Nga ana e palës ankuese nuk u dërgua asnjë përgjigje dhe pse sipas fletës së Lajmërim Marrjes nr. RR811497565AA të Zyrës Postare rezultoi që ka marrë dijëni në datën 04.02.2026.
- Me shkresën nr.47 prot., datë 03.02.2026⁴, Bashkia Vlorë, ktheu përgjigje Komisionerit dhe dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me këtë çështje, ku informon se:

Në vijim të shkresës dërguar pranë Bashkisë Vlorë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi më datë 21.01.2026, nr. 84/1 Prot., ju lutem gjeni informacionin si më poshtë:

1. Roli i Bashkisë në menaxhimin e Qendrës së Kujdesit Ditor dhe për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara. Qendra e Kujdesit Ditor ka filluar të ofrojë shërbime në Bashkinë Vlorë në muajin qershor 2025 dhe është kërkuar licencimi i shërbimeve pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Vendimi i miratimit të shërbimeve është marrë me datë 27.10.2025 dhe prej kësaj date qendra ka vijuar të ofrojë shërbime të licencuara. Qendra e Kujdesit Ditor është ngritur si strukturë pranë Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe është mbështetur në ngritjen e saj nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri nëpërmjet projektit "Krijimi i një shërbimi të ri të specializuar të kujdesit social për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në Bashkinë Vlorë përmes nën-granteve të programit "BE për Kujdesin Social", mbështetur nga UNICEF Albania me fonde të Bashkimit Europian.

³ Administruar pranë Komisionerit me nr.84/5 prot, datë 03.02.2026.

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.84/7 prot, datë 03.02.2026.

Bashkia Vlorë ka rolin e partnerit në këtë projekt, i cili përfundon në mesin e muajit maj 2026, kohë pas së cilës Bashkia Vlorë do të vijojë të ofrojë të gjitha shërbimet. Vazhdimësia e shërbimeve është parashikuar edhe në buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026. Aktualisht, Qendra e Kujdesit Ditor menaxhohet nga Qendra e Zhvillimit, Bashkia Vlorë, dhe Qendra për Drejtësi Gjinore ka rol mbështetës në këtë proces.

Lidhur me tipologjinë e shërbimeve, e cila do të vijojë të ofrohet tërësisht nga Bashkia Vlorë, ju lutem referojuni informacionit më poshtë: Qendra e Kujdesit Ditor, e ngritur pranë Qendrës së Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara, me adresë: lagjia "Pavarësia", Skelë, Vlorë, qëndron e hapur dhe funksionale në orarin 07:30 — 16:30, nga e hëna në të premte dhe ofron një paketë të plotë shërbimesh për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara.

Kategoritë që përfitojnë dhe shërbimet e ofruara janë:

- *Fëmijë me aftësi të kufizuara, në moshë shkollore (6–17 vjeç), të cilët marrin shërbime për ditën e plotë ose gjysmë dite (pas procesit mësimor) në Qendrën e Kujdesit Ditor.*

Shërbimet përfshijnë:

- 1. terapi zhvillimi;*
- 2. fizioterapi;*
- 3. logopedi;*
- 4. këshillim dhe asistencë psikologjike;*
- 5. aktivitete okupacionale dhe terapi arti.*

Për prindërit ofrohet mundësia për t'i sjellë fëmijët e tyre në Qendër në orën 07:30 të mëngjesit ose pas shkollës, ku ata mund të qëndrojnë deri në orën 16:30 dhe të marrin shërbimet sipas nevojave të identifikuara.

- *Të rinj me aftësi të kufizuara, të moshës 18–21 vjeç, të cilët marrin shërbime të specializuara me orë, të përshtatura sipas nevojave të tyre, të cilat përfshijnë:*

- 1. terapi zhvillimi;*
- 2. fizioterapi;*
- 3. logopedi;*
- 4. këshillim dhe asistencë psikologjike;*
- 5. aktivitete okupacionale dhe terapi arti.*

Përfitues të tjerë të shërbimeve janë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë shërbimet si më poshtë:

- 1. mbështetje psikologjike;*
- 2. sesione informimi për prindërimin pozitiv;*

3. psikoterapi në grup.

2. Sqarim nëse Bashkia Vlorë ka marrë njohuri për ndërprerjen e transportit nga Shkolla Speciale dhe nëse ka ndërmarrë veprime për të adresuar këtë problem.

Qendra e Zhvillimit ka marrë dijeni për ndërprerjen e shërbimit të transportit nga Shkolla Speciale. Megjithatë, sqarojmë se Qendra e Zhvillimit nuk ka asnjë marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën Speciale në lidhje me transportin e përfituesve të Qendrës Ditore. Shkolla Speciale ka marrëveshje të veçantë vetëm me prindërit e nxënësve të saj për shërbimin e transportit. Për rrjedhojë, në mungesë të një marrëveshjeje formale, QZHPAK nuk ka pasur detyrim për të ofruar shërbimin e transportit për përfituesit e Qendrës Ditore.

3. Informacion nëse Bashkia Vlorë ka plan për të siguruar transportin për fëmijët që frekuentojnë Qendrën Ditore, në mënyrë që ata të mos diskriminohen në aksesin në shërbime.

Qendra Ditore, në kontratën e lidhur me prindërit, nuk e parashikon shërbimin e transportit si pjesë të tipologjisë së shërbimeve që ofron. Për rrjedhojë, aktualisht nuk ekziston një detyrim kontraktual për ofrimin e këtij shërbimi nga Qendra Ditore. Bashkëlidhur keni dhe një kopje të marrëveshjes së lidhur me prindin.

4. Sqarim nëse Bashkia Vlorë ka marrë masa për të garantuar që Shkolla Speciale të mos keqinformojë prindërit për funksionimin e Qendrës Ditore (p.sh., pretendimin se Qendra do të mbyllet).

QZHPAK nuk ka informacion dhe nuk është në dijeni të keqinformimit për të cilin kërkohet informacion.

5. Informacion nëse Bashkia Vlorë ka një protokoll bashkëpunimi me Shkollën Speciale për transportin e fëmijëve drejt Qendrës Ditore.

QZHPAK aktualisht nuk ka protokoll bashkëpunimi me Shkollën Speciale për transportin e fëmijëve drejt Qendrës Ditore.

6. Sqarim mbi masat që do të ndërmerren nga Bashkia Vlorë për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të mos humbasin shërbimet pas procesit mësimor për shkak të mungesës së transportit.

Referuar sqarimeve të dhëna në pikat 2 dhe 3, QZHPAK thekson se, në pjesë të shërbimit të saj për ofrimin e shërbimit të transportit, nuk ka pasur përgjegjësi direkte në këtë drejtim. Megjithatë, QZHPAK shpreh gatishmërinë për bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe Shkollën Speciale, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët institucionale që garanton vazhdimësinë e shërbimeve dhe përmirësimin e aksesit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e palës ankuese, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se pala ankuese është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;

- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga pala ankues, në radhë të parë Komisioneri do të analizojë nëse nxënësja Tereza Çelaj, në rastin konkret, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo më pak të favorshëm nga ana e Shkollës Speciale Vlorë, në lidhje me ofrimin e shërbimeve mbështetëse pas përfundimit të procesit mësimor, përfshirë transportin drejt Qendrës së Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara dhe mundësinë e aksesit të barabartë në këto shërbime.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

Nga analiza e informacionit të paraqitur në ankesë rezulton se, që prej muajit qershor 2025, në Bashkinë Vlorë funksionon Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara, e krijuar në bashkëpunim ndërmjet Qendrës për Drejtësi Gjinore dhe Bashkisë Vlorë, në kuadër të një projekti të mbështetur nga UNICEF Albania dhe Bashkimi Europian. Qendra ofron shërbime të specializuara pas përfundimit të procesit mësimor për mbi 35 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Sipas pretendimeve të subjektit ankues, në muajt e fundit është krijuar një situatë problematike me Drejtorinë e Shkollës Speciale në Vlorë. Fillimisht, transporti i disa fëmijëve nga Shkolla Speciale drejt Qendrës së Kujdesit Ditor realizohet nga vetë shkolla, pasi qendra nuk ofron shërbim transporti. Megjithatë, që nga muaji nëntor 2025, ky shërbim është ndërprerë vetëm për fëmijët që frekuentojnë Qendrën Ditore, ndërkohë që transporti vijon të ofrohet për fëmijët e tjerë të shkollës drejt banesave të tyre. Sipas subjektit ankues, kjo situatë përbën trajtim të pabarabartë dhe diskriminues ndaj këtyre fëmijëve.

Referuar rastit të fëmijës T. Ç., 8 vjeçe, fëmijë me aftësi të kufizuara, për të cilën nëna e saj, R. Gj., e cila është kujdestare e vetme, pretendohet se ka të pamundur ta shoqërojë çdo ditë nga Shkolla Speciale drejt Qendrës së Kujdesit Ditor dhe më pas ta marrë sërish në përfundim të shërbimit. Sipas pretendimeve të paraqitura nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri dhe R. Gj., për shkak të mosofrimit të transportit nga Shkolla Speciale dhe qëndrimeve të shprehura nga drejtuesja e këtij institucioni, ekziston rreziku që T. Ç., të mos përfitojë nga shërbimet e specializuara të Qendrës Ditore dhe madje të stimulohet indirekt braktisja e arsimit të detyrueshëm. Gjithashtu, sipas ankuesve, disa prindër janë informuar në mënyrë të pasaktë se Qendra e Kujdesit Ditor do të mbyllet, çka ka ndikuar që disa fëmijë të mos e frekuentojnë më këtë shërbim.

Në datën 01.07.2025 është lidhur një Marrëveshje ndërmjet Qendrës së Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara në Vlorë, e përfaqësuar nga drejtoresha E. G., dhe znj. R. Ç., në cilësinë e prindit/kujdestarit të fëmijës T. Ç. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ofrimi i shërbimeve të specializuara për fëmijën me aftësi të kufizuara pranë Qendrës së Kujdesit Ditor, për një periudhë të përcaktuar me të drejtë përtëritjeje në vijim sipas nevojave të fëmijës dhe familjes.

Sipas marrëveshjes, fëmija përfiton një paketë shërbimesh të specializuara ditore, të cilat përfshijnë:

- kujdes ditor me kohë të plotë ose gjysmë dite (pas përfundimit të procesit mësimor);
- shërbim psikologjik;
- terapi zhvillimi për mbështetjen e zhvillimit të aftësive;
- aktivitete okupacionale dhe terapi arti, me qëllim stimulimin e zhvillimit social dhe emocional;
- si dhe shërbime mbështetëse gjatë qëndrimit në qendër, përfshirë ofrimin e vaktit të drekës dhe një mesvakti.

Gjithashtu, marrëveshja parashikon edhe shërbime mbështetëse për prindin, të cilat përfshijnë:

- këshillim për përmirësimin e kujdesit ndaj fëmijës;
- sesione informuese për prindërimin pozitiv;
- psikoterapi në grup për mbështetje psikologjike dhe sociale të prindërve.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Qendra merr përsipër të ofrojë shërbimet në mënyrë profesionale nga staf i specializuar, të realizojë vlerësimin e nevojave të përfituesit dhe të monitorojë vazhdimisht procesin e ofrimit të shërbimeve. Nga ana tjetër, prindi angazhohet të bashkëpunojë me stafin e qendrës, të respektojë oraret e shërbimeve, të mbështesë zhvillimin e fëmijës dhe të sigurojë frekuentimin e rregullt të arsimit të detyrueshëm.

Për këto arsye, subjekti ankues kërkon ndërhyrjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të shqyrtuar pretendimet dhe për të marrë masa që Shkolla Speciale të sigurojë transportin edhe për fëmijët që ndjekin shërbimet e Qendrës Ditore, në të njëjtën mënyrë si për fëmijët e tjerë të shkollës, duke garantuar akses të barabartë në shërbime.

Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP) Himarë–Vlorë, në përgjigjen e saj, sqaron se nuk ka pasur më parë asnjë njoftim apo ankesë zyrtare të protokolluar lidhur me problematikën e ngritur në ankesë. Sipas saj, Shkolla Speciale Vlorë ka informuar se nuk ekziston asnjë marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën e Kujdesit Ditor për transportin e nxënësve drejt kësaj qendre. ZVAP thekson se transporti i nxënësve realizohet në bazë të një kontrate të lidhur nga Bashkia Vlorë me një subjekt privat dhe është i dedikuar vetëm për itinerarin banesë–shkollë–banesë. Gjithashtu, ZVAP sqaron se kompetenca e saj lidhet me procesin arsimor dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve gjatë orarit mësimor, ndërsa menaxhimi i shërbimeve sociale dhe financimi i transportit drejt shërbimeve të tjera pas procesit mësimor konsiderohet kompetencë e pushtetit vendor. Në këtë kuadër, institucioni shprehet se, në mungesë të një marrëveshjeje apo kërkesë zyrtare për bashkëpunim, nuk ka qenë në kushtet për të ndërmarrë veprime.

Shkolla Speciale Vlorë, në përgjigjen e saj, deklaron se funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin dhe se nuk disponon asnjë kërkesë apo dokument zyrtar për bashkëpunim me Qendrën e Kujdesit Ditor lidhur me transportin e nxënësve pas përfundimit të procesit mësimor. Sipas këtij institucioni, shërbimi i transportit ofrohet vetëm për itinerarin banesë–shkollë–banesë

dhe realizohet përmes një kontrate të lidhur nga Bashkia Vlorë. Shkolla sqaron se nuk ka pasur as fillim dhe as ndërprerje zyrtare të transportit drejt Qendrës Ditore, pasi një shërbim i tillë nuk ka qenë i miratuar institucionalisht. Lidhur me rastin e nxënësës T. Ç., shkolla deklaron se transporti nga banesa në shkollë dhe anasjelltas nuk i është mohuar në asnjë moment dhe se nuk disponon prova për deklaratat që pretendohet se i janë bërë nënës së saj. Shkolla thekson gjithashtu se nuk ka kompetencë për të lidhur marrëveshje ndërinstitucionale pa miratimin e instancave më të larta dhe se siguria dhe interesi më i lartë i fëmijëve mbeten prioritet.

Bashkia Vlorë, përmes Qendrës së Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, informon se Qendra e Kujdesit Ditor ka filluar të ofrojë shërbime në muajin qershor 2025 dhe është licencuar në tetor 2025. Qendra ofron shërbime të ndryshme terapeutike dhe mbështetëse për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, si dhe për prindërit e tyre, dhe funksionon çdo ditë nga ora 07:30 deri në 16:30. Bashkia sqaron se qendra nuk ka të parashikuar në kontratat me prindërit shërbimin e transportit dhe se nuk ekziston një marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën Speciale Vlorë për transportin e fëmijëve drejt Qendrës Ditore. Gjithashtu, theksohet se nuk ka informacion zyrtar lidhur me pretendimet për keqinformim të prindërve nga ana e shkollës. Megjithatë, institucioni shpreh gatishmërinë për bashkëpunim me institucionet përkatëse për të gjetur një zgjidhje institucionale që të përmirësojë aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në këto shërbime.

E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Bazuar në Kushtetutë, kushdo ka të drejtën për arsimim. Bazuar në nenin 2, të ligjit Nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, arsimi parashkollor është pjesë e arsimit parauniversitar.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19 (Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve) parashikon: *Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Neni 63 (Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara) parashikon: *1. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, me qëllim përgatitjen për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. 2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione arsimore të specializuara është përgjithësisht e përkohshme, ndërsa përfshirja dhe integrimi i tyre në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore. 3. Nxënësve që nuk dëgjojnë e nuk flasin u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë u garantohet përdorimi i shkrimit Brail.*

Neni 64 (Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara) parashikon: *1. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në institucionet e arsimit parauniversitar sipas kriterëve të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin dhe Ministri i Shëndetësisë. 2. Nxënësi me aftësi të kufizuara mund të qëndrojë në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç.*

3.Njësia arsimore vendore krijon një komision të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të institucionit arsimor dhe jep rekomandimet për ndjekjen e një institucioni arsimor të zakonshëm ose të specializuar. 4. Prindërit vendosin nëse fëmija i tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. 5.Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit dhe komisionin përkatës, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore përkatëse. 6Njësia arsimore vendore mund të sigurojë arsimim në shtëpi për nxënësit që nuk mund të ndjekin një institucion arsimor të zakonshëm ose të specializuar.

Neni 65 (Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara) parashikon: 1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor dhe programeve lëndore të zakonshme të përshtatura për ta, ose sipas planeve dhe programeve të specializuara. 2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision i përbërë nga mësues dhe psikologë, në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. 3.Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbime rehabilituese sipas kritereve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. 4.Njësia përkatëse e qeverisjes vendore siguron mjedise të përshtatshme për mësimdhënie dhe të nxënësve për këta nxënës, sipas standardeve të përcaktuara.

Nga analiza e kuadrit ligjor që rregullon sistemin arsimor parauniversitar rezulton se legjislacioni shqiptar i nje fëmijëve me aftësi të kufizuara të drejtën për përkujdesje të posaçme nga shteti dhe akses të plotë në arsim, në mënyrë që të garantohet zhvillimi i tyre i plotë dhe integrimi në shoqëri. Qëllimi i këtij kuadri ligjor është që këta fëmijë të përfitojnë jo vetëm nga procesi arsimor, por edhe nga shërbimet mbështetëse që ndihmojnë zhvillimin e tyre intelektual, fizik dhe social.

Në këtë kuptim, legjislacioni vendos detyrime për institucionet publike, veçanërisht për institucionet arsimore dhe strukturat vendore arsimore, për të siguruar kushte të përshtatshme për ndjekjen e arsimit nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Këto detyrime përfshijnë organizimin e procesit arsimor në mënyrë të përshtatur me nevojat e tyre, ofrimin e programeve të personalizuara, si dhe garantimin e mbështetjes pedagogjike dhe rehabilituese përmes specialistëve përkatës. Gjithashtu, institucionet përgjegjëse duhet të krijojnë mjedise të përshtatshme dhe të sigurojnë bashkëpunim me prindërit dhe me institucionet e tjera për të garantuar përfshirjen dhe përfitimin e plotë të fëmijëve nga sistemi arsimor.

Nga ana tjetër, legjislacioni nje edhe rolin e rëndësishëm të prindërve në vendimmarrjen për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke u dhënë atyre të drejtën të zgjedhin institucionin arsimor më të përshtatshëm dhe të bashkëpunojnë me institucionet në hartimin dhe zbatimin e programeve të personalizuara për zhvillimin e fëmijës.

Në kontekstin e rastit konkret, kjo logjikë ligjore nënkupton se institucionet publike duhet të veprojnë në mënyrë të koordinuar dhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës, duke siguruar që ai të ketë mundësi reale për të ndjekur procesin arsimor dhe për të përfituar nga shërbimet

mbështetëse që kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e tij. Në këtë kuadër, çdo vendimmarrje apo veprim institucional duhet të synojë shmangien e pengesave që mund të kufizojnë aksesin e fëmijës në arsim dhe në shërbimet që ndihmojnë zhvillimin e tij.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 1.3.2023, “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, në pikën 1, shkronjat “c” dhe “ç”, është parashikuar si më poshtë:

- Shkronja “c”: *Nxënësit që jetojnë në qendra rezidenciale, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike), përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të transportit.*
- Shkronja “ç”: *“Nxënësit e arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara, që gëzojnë statusin ligjor të personit me aftësi të kufizuara (PAK) (përfshirë ata që nuk shikojnë, nuk dëgjojnë, si dhe personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë), gjithashtu përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të transportit për të ndjekur procesin mësimor në institucionet arsimore publike.”*

Në pikën 2, është përcaktuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) organizojnë linjat e transportit dhe përlllogarisin fondet për nxënësit dhe punonjësit përfitues, përfshirë nxënësit me aftësi të kufizuara, bazuar në distancën dhe numrin e ditëve mësimore.

Në pikën 3, përlllogaritja e fondeve bëhet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore të ndjekura nga nxënësit dhe tarifës së biletës, duke përfshirë edhe subvencionimin e kostos për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Në pikën 4, ZVAP-et dhe ofruesit e arsimit profesional publik sigurojnë pagesat për shpenzimet e transportit për nxënësit me aftësi të kufizuara, përmes llogarive bankare të prindërve, kujdestarëve ligjorë apo përfituesve me prokurë të posaçme, ose përmes shërbimit postar, në zonat ku shërbimi bankar mungon ose është i vështirë për t’u aksesuar.

Në pikën 8, është përcaktuar që efektet financiare për transportin e nxënësve me aftësi të kufizuara mbulohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe nga buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore, duke siguruar qasje të barabartë në arsim për këtë kategori. Kjo strukturë garanton që nxënësit me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të plota për të ndjekur mësimin, pavarësisht nga distanca dhe vështirësitë në aksesin e transportit.

Sa më sipër, duke u bazuar në analizën e dokumenteve të administruara nga palët gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe kuadrit ligjor në fuqi, mund të konkludohet se veprimet e institucioneve publike për rastin e fëmijës T. Ç., 8 vjeçe, e diagnostikuar me çrregullim të spektrit autik (CSA),

janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin dhe marrëveshjet ekzistuese, duke respektuar të drejtën e saj për arsimim dhe akses në shërbime mbështetëse.

Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara në Vlorë që në qershor 2025, ka ofruar shërbime të specializuara për fëmijë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë kujdes ditor, terapi zhvillimi, aktivitete okupacionale, terapi arti, shërbim psikologjik dhe mbështetje për prindin.

Marrëveshja datë 01.07.2025 midis drejtores së Qendrës, znj.E. G., dhe prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës T. Ç., R. Gj., ka përcaktuar qartë përbajtjen e shërbimeve të ofruara dhe përgjegjësitë e secilës palë. Në këtë kuadër, Qendra mban përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve në mënyrë profesionale dhe për monitorimin e vazhdueshëm të progresit të fëmijës, ndërsa prindi ka detyrimin të sigurojë frekuentimin e rregullt dhe bashkëpunimin me stafin për zhvillimin optimal të fëmijës.

Nga ana tjetër, shqyrtimi i dokumentacionit tregoi se Shkolla Speciale Vlorë nuk ofron shërbim transporti drejt Qendrës Ditore, pasi kjo nuk është parashikuar nga kontrata e Bashkisë Vlorë me subjektin privat që menaxhon transportin për itinerarin banesë–shkollë–banesë. Megjithatë, shkolla ka kryer të gjitha detyrimet e saj ligjore dhe administrative në kuadër të procesit arsimor, duke siguruar transportin e nxënësve nga banesa në shkollë dhe anasjelltas, duke garantuar pjesëmarrjen e tyre të rregullt në mësim, ndjekjen e programeve të specializuara brenda shkollës dhe respektimin e të drejtave të nxënësve për arsimim të plotë dhe të sigurt. Në këtë kuadër, çdo pengesë e mundshme lidhur me transportin drejt Qendrës Ditore nuk mund të imputohet shkollës, e cila ka vepruar në përputhje me kontratën dhe detyrimet që i takojnë, duke përbushur përgjegjësitë e saj për sigurimin e aksesit në arsimin bazë dhe integrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në mjedisin shkollor.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Himarë-Vlorë dhe Shkolla Speciale kanë deklaruar se nuk ka ekzistuar asnjë marrëveshje bashkëpunimi për transport të nxënësve drejt Qendrës Ditore. Nga ky qëndrim rezulton se institucionet nuk kanë vepruar në mënyrë arbitrare, por kanë respektuar kufizimet ligjore dhe detyrimet e përcaktuara në kontratat ekzistuese dhe në legjislacionin në fuqi.

Legjislacioni shqiptar, konkretisht VKM nr.119, datë 01.03.2023, parashikon në pikën 1, shkronjat “c” dhe “ç” kategoritë e nxënësve që përfitojnë mbulim të shpenzimeve të transportit: *Nxënësit që jetojnë në qendra rezidenciale dhe udhëtojnë mbi 2 km për të ndjekur mësimin; Nxënësit e arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, përfshirë ata që nuk shikojnë, nuk dëgjojnë, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.*

Nga analiza e këtij kuadri ligjor dhe marrëveshjeve të shërbimit, del qartë se T. Ç., përfiton të drejtën për shërbime mbështetëse dhe arsim në institucionet arsimore, banesë-shkollë-banesë dhe nuk i është mohuar në asnjë moment, por transporti i saj drejt Qendrës Ditore nuk është i parashikuar dhe nuk mund të konsiderohet shkelje ligjore, pasi shërbimi i transportit mbulohet vetëm nga itinerari zyrtar banesë–shkollë dhe nga fondet e Bashkisë dhe ministrisë për nxënësit përfitues sipas VKM-së.

Referuar pikës “ç” të VKM nr.119, datë 01.03.2023, transporti për nxënësit me aftësi të kufizuara përfshin vetëm ata me status ligjor të invalidit. T. Ç., e diagnostikuar me çrregullim të spektrit autik, nuk përfshihet në këtë kategori. Për pasojë, transporti drejt Qendrës Ditore nuk është i parashikuar ligjërisht dhe nuk përbën shkelje nga Shkolla Speciale Vlorë, e cila ka kryer të gjitha detyrimet e saj për pjesëmarrjen e rregullt të nxënësve në procesin mësimor.

Në këtë kontekst Komisioneri konstaton se, institucionet kanë respektuar detyrimet e tyre ligjore:

- Qendra Ditore ka ofruar shërbime të specializuara sipas marrëveshjes me prindin, duke përmbytur detyrimet kontraktuale dhe ligjore për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Shkolla Speciale dhe ZVAP Vlorë kanë vepruar brenda kuadrit të kompetencave ligjore dhe nuk kanë ndërhyrë në kontratat dhe shërbimet e tjera jashtë itinerarit të parashikuar;
- Bashkia Vlorë, përmes kontratës me subjektin privat, ka garantuar transportin për itinerarin bazë, në përputhje me VKM nr.119/2023.

Gjithashtu, legjislacioni i arsimit parauniversitar (Ligji nr.69/2012, nenet 63–65) siguron të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim, integrim dhe mbështetje të specializuar, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe rolin e prindit. Bazuar në këtë, çdo pretendim për trajtim të padrejtë ose diskriminues duhet të vlerësohet kundrejt bazës kontraktuale dhe kuadrit ligjor, të cilat në këtë rast konfirmojnë respektimin e të drejtave të fëmijës.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm, si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të rastit, Komisioneri vlerëson se nxënësjja T. Ç., 8 vjeçe, nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshëm ose të pabarabartë nga Shkolla Speciale Vlorë në lidhje me shërbimin e transportit nga banesa në shkollë dhe anasjelltas. Institucioni ka ofruar transportin e parashikuar dhe të organizuar në bazë të kontratës me Bashkinë Vlorë, duke garantuar që Tereza të ketë mundësi të ndjekë procesin mësimor pa pengesa, dhe nuk ka veprime që të kenë kufizuar aksesin e saj në mësim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se, pavarësisht se institucionet e përfshira kanë vepruar brenda kompetencave dhe përgjegjësi të tyre operative, është thelbësore që të gjitha strukturat arsimore, sociale dhe vendore të ndërveprojnë dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar. Bashkëpunimi institucional duhet të përfshijë planifikimin strategjik të shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, organizimin efikas të transportit dhe logjistikës, si dhe krijimin e kanaleve të komunikimit të qartë, të dokumentuar dhe të institucionalizuar midis shkollave, autoriteteve vendore, qendrave ditore dhe prindërve.

Ky koordinim të synojë të eliminojë çdo pengesë që mund të kufizojë aksesin e barabartë në arsim dhe në shërbimet mbështetëse, duke garantuar një mjedis gjithëpërfshirës, të sigurt dhe mbështetës, ku interesi dhe mirëqenia e fëmijës vendosen në qendër të veprimtarisë institucionale. Komisioneri vlerëson se bashkëpunimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i strukturuar, duke përfshirë monitorimin e shërbimeve, vlerësimin e nevojave individuale të fëmijëve, ndërveprimin aktiv me familjet dhe

krijimin e mekanizmave që sigurojnë reagim të shpejtë ndaj çdo problemi që mund të lindë në procesin e përfshirjes së fëmijëve.

Gjithashtu, Komisioneri nxit institucionet të zhvillojnë protokolle operative të përbashkëta, të përshtatura për realitetin lokal dhe nevojat specifike të çdo fëmije, duke forcuar mbështetjen pedagogjike, terapinë dhe aktivitetet zhvilluese pas mësimit. Kjo qasje institucionale, gjithëpërfshirëse dhe proaktive, të sigurojë që çdo fëmijë të ketë mundësi reale për të ndjekur procesin arsimor dhe përfitimet mbështetëse, duke forcuar koordinimin ndërinstitucional, përgjegjësinë sociale dhe angazhimin e strukturave vendore dhe arsimore në interes të mirëqenies së plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlereson se, duke pasur parasysh se nga maji 2026 Qendra e Kujdesit Ditor do të menaxhohet drejtpërdrejt nga Bashkia Vlorë, ZVAP Himarë-Vlorë ka detyrimin të koordinojë veprimet me Bashkinë Vlorë dhe institucionet sociale për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, ZVAP duhet të monitorojë pjesëmarrjen e rregullt të fëmijëve në procesin arsimor, të sigurojë bashkëpunimin me prindërit dhe Shkollën Speciale Vlorë, dhe të mbikëqyrë organizimin e transportit dhe të shërbimeve pasmësimore në mënyrë që të plotësohen nevojat e fëmijëve.

Komisioneri vlereson se institucionet përgjegjëse kanë detyrimin ligjor dhe institucional të veprojnë në koordinim të plotë për të garantuar akses të barabartë të fëmijëve në arsim dhe shërbime mbështetëse, duke vendosur si prioritet interesin më të lartë të fëmijës, përfshirjen e tij sociale, dinjitetin dhe pjesëmarrjen e sigurt dhe gjithëpërfshirëse në procesin arsimor.

Ndërkohë, Komisioneri vlerëson se përdorimi i terminologjisë “invalid” në aktet nënligjore, përfshirë Vendimin nr. 119, datë 1.3.2023, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, nuk është i përshtatshëm dhe kërkon rishikim për t’u harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet bashkëkohore ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara (PAK).

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 108/2012, në nenin 4/b “Detyrime të përgjithshme”, parashikon se shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar. Në këtë kuadër, ato janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe masa legjislative, për të ndryshuar ose shfuqizuar çdo dispozitë, praktikë apo terminologji ekzistuese që përbën diskriminim ose cenon dinjitetin e këtyre personave.

Në këtë frymë, Konventa afirmon përdorimin e terminologjisë “persona me aftësi të kufizuara”, duke theksuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, që respekton dinjitetin e lindur, autonominë individuale, barazinë dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri, si dhe shmang çdo gjuhë që stigmatizon, etiketon apo e identifikon individin vetëm me aftësinë e kufizuar.

Në përputhje me këtë qasje, Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në nenin 20 “Ndryshimet në legjislacion”, parashikon që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim përshtatjen e formulimeve, terminologjisë dhe përmbajtjes së tyre me modelin bashkëkohor të aftësisë së kufizuar. Ky model thekson respektimin e autonomisë, të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.

Ligji gjithashtu përcakton qartë statusin e personave me aftësi të kufizuara dhe garanton të drejta konkrete për përfshirjen e tyre në fusha të tilla si arsimi parauniversitar, transporti, si dhe shërbimet sociale dhe profesionale. Në këtë kuadër, ai vendos përdorimin e terminologjisë “persona me aftësi të kufizuara (PAK)” si standard ligjor për të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore si dhe çdo dokument zyrtar.

Sa më sipër, përdorimi i termit “invalid” në aktet ligjore/nënligjore bie ndesh me këto parime dhe krijon mospërputhje me kuadrin ligjor kombëtar, duke cënuar koherencën juridike dhe duke ngarkuar gjuhën me një konotacion stigmatizues. Dokumentet strategjike kombëtare, përfshirë Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2018–2025), theksojnë përdorimin e një gjuhe gjithëpërfshirëse, respektuese dhe të bazuar në të drejtat e individit, duke promovuar pjesëmarrjen e plotë dhe mosdiskriminimin në të gjitha sferat e jetës.

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, rezulton e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin masa të menjëhershme dhe të vazhdueshme për rishikimin dhe përditësimin e të gjitha akteve nënligjore ekzistuese, si dhe të sigurojnë që çdo akt i ri që do të miratohet në vijim të jetë i harmonizuar plotësisht me parimet dhe terminologjinë e përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar. Në veçanti, këto masa duhet të synojnë eliminimin e çdo terminologjie të papërshtatshme ose diskriminuese dhe zëvendësimin e saj me terminologjinë “persona me aftësi të kufizuara (PAK)”, duke reflektuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, që garanton respektimin e dinjitetit, barazinë dhe përfshirjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri.

Sa më sipër, referuar rastit, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me diferencë në trajtim nga ana Shkollës Speciale Vlorë, për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese dhe për rrjedhojë nuk provohet se ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të fëmijës T. Ç. dhe ankuseses znj. R. Gj., nga Shkolla Speciale

Vlorë, për shkaqet e pretenduara.

2. Rekomandohet Bashkia Vlorë, ZVAP Himarë–Vlorë, Shkolla Speciale Vlorë dhe Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara, me qëllim garantimin e aksesit të barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shërbimet arsimore dhe mbështetëse, të ndërmarrin masat e nevojshme për sigurimin e transportit dhe bashkëpunimin institucional, të marrë masat e mëposhtme:
 - Bashkia Vlorë të organizojë dhe menaxhojë transportin mbas procesit mësimor për nxënësit e Qendrës Ditore, duke hartuar një plan operacional të transportit, duke siguruar fondet e nevojshme dhe duke monitoruar vazhdimësinë e shërbimit për të garantuar pjesëmarrjen e rregullt dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
 - ZVAP Vlorë-Himarë duhet të koordinojë veprimet me Bashkinë Vlorë dhe Shkollën Speciale Vlorë, duke mbikëqyrur pjesëmarrjen e nxënësve në arsim, duke forcuar komunikimin institucional dhe duke krijuar mekanizma reagimi të shpejtë ndaj çdo pengese në aksesin e shërbimeve, duke vendosur si prioritet interesin më të lartë të fëmijës dhe garantuar vazhdimësinë e shërbimeve mbështetëse.
 - Shkolla Speciale Vlorë duhet të koordinojë veprimet me Bashkinë Vlorë, ZVAP Himarë–Vlorë dhe Qendrën Ditore, duke informuar dhe bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme për organizimin e transportit të nxënësve pas procesit mësimor, duke garantuar dorëzimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes së tyre në shërbimet arsimore dhe mbështetëse.
3. Rekomandohet që Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimin e Vendimit nr. 119, datë 1.3.2023, të ndryshuar, duke zëvendësuar termin “invalid” me “person me aftësi të kufizuara (PAK)”, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, legjislacionin kombëtar dhe dokumentet strategjike në fuqi, me qëllim garantimin e një terminologjie të unifikuar, jo-diskriminuese dhe në respekt të dinjitetit njerëzor.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA